



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE KONTROLLIT TË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Nr. 3832/6 / Prot.

Maliq, më 24.09.2021

Lënda: Kërkesë për Afishim Publik

Drejtuar : DREJTORISË SË INFORMIMIT PUBLIK DHE MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

ZYRËS ME NJË NDALESË

Këtu

Në kuadër të bashkëpunimit, ju bëjmë me dije se pranë Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, është dërguar shkresa nga Agjencia Shtetërore e Shpronësimit Nr. 291/4 Prot., datë 20.09.2021, me lëndë "Njoftim për pranimin e kërkesës për shpronësim me interes publik", protokolluar pranë Bashkisë Maliq Nr. 3832/4 Prot., datë 22.09.2021, në lidhje me pasuritë e paluajtshme private që preken nga zbatimi i projektit "Rikualifikimi Urban i Lulishtes Panoramike pranë Lumit Devoll, Blloku Nr.1, Qyteti Maliq".

Bashkëlidhur do të gjeni kopje të shkresës së sipërcituar.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim Topçiu



*Nr. 104 704
Dt. 07.10.2021*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

- D.P.K. P.H.T
22.09.2021

[Handwritten signature]

BASHKISIA MALI

Zyra e Protokollit

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
AGJENCIA SHTETËRORE PËR SHPRONËSIMIN
KOMISIONI I POSAÇËM I SHPRONËSIMIT

Nr. 3832/4 Prot.

Date: 22.09.2021

Nenshkrimi

Nr. 291/4 Prot.

Tiranë, më 20.09.2021

Lënda: Njoftim për pranimin e kërkesës për shpronësim me interes publik.

BASHKISË MALIQ

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq

Maliq

Referuar nenit 13, të Ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik", i ndryshuar, si dhe në vijim të kërkesës Tuaj nr. 3832 prot., datë 08.07.2021, protokolluar në ASHSH me nr. 291 prot., datë 14.07.2021, "Për shpronësim për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikualifikimi urban i lulishtes panoramike pranë Lumit Devoll, blloku nr.1, Qyteti Maliq", Ju bëjmë me dije:

Pranimin e kërkesës për shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikualifikimi urban i lulishtes panoramike pranë Lumit Devoll, blloku nr.1, Qyteti Maliq", me vlerë totale paraprake të shpronësimit 858,333 (tetëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë.

Personi i autorizuar nga ana Juaj, duhet të paraqitet në Agjencinë Shtetërore për shpronësim brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e këtij njoftimi, për nënshkrimin e akt-marrëveshjes për të drejtat dhe detyrimet që lidhen me realizimin e procesit të shpronësimit të pasurive që përfshihen në këtë projekt.

Sa më sipër, si dhe bazuar në pikën 6, të VKM nr.127, datë 23.03.2000 "Për përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe të njoftimit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurive pronë private për interes publik", kërkojmë nga ana juaj që, njoftimi i kërkesës për shpronësim të afishohet në ambjentet e Bashkisë Maliq, si dhe në mungesë të adresës së pronarëve të shpronësuar, kërkojmë nga ana Juaj marrjen e masave për njoftimin e tyre.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

Drejtor i Përgjithshëm

Kryetar

i Komisionit të Posaçëm të Shpronësimeve

Erlis Hereni

[Handwritten signature]

